



T | PRVW00 | 0

ZALIJEPITI NALJEPNICU UÇENIKA



BIOLOGJI

KONTROLLIMI EKSTERN I NJOHURIVE TË NXËNËSVE NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE

PRILL, VITI SHKOLLOR 2025-2026

UDHËZIME

KOHA PËR ZGJIDHJEN E TESTIT ËSHTË: 60 MINUTA

Mjetet e lejuara: lapsi grafit, goma dhe stilolapsi.

Lexoni me kujdes çdo detyrë dhe udhëzimet që janë shkruar para çdo grupi të detyrave.

Nëse një detyrë e zgjidhni në më shumë mënyra, shënoni qartë se cilën zgjidhje duhet ta vlerësojë vlerësuesi.

Zgjidhjen e detyrës/pyetjes DUHET patjetër ta shkruani në vendin e paraparë për atë detyrë/pyetje.

GJATË PUNËS NË TEST NUK LEJOHET PËRDORIMI I PAJISJEVE ELEKTRONIKE DHE KORREKTUESIT.

Detyra do të vlerësohet me 0 pikë nëse:

- ▶ është e pazgjidhur ose e zgjidhur gabim
- ▶ zgjidhja është shkruar në vend që nuk është i paraparë për atë detyrë/pyetje
- ▶ janë rrethuar më shumë përgjigje të ofruara
- ▶ është shkruar në mënyrë të palexueshme dhe të paqartë.

Nëse gaboni, vijëzojeni dhe zgjidheni përsëri.

TË UROJMË SHUMË SUKSES!



T | PRV00 | 1

Në pyetjet nga 1 deri në 5 rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

1



P | HXTY8 | 1

Viruset janë ndërtuar nga:

- A. membrana qelizore dhe materiali i trashëgimisë
- B. muri qelizor, kapsidi, qafa dhe këmbët
- C. membrana qelizore, qafa dhe këmbët
- D. kapsidi dhe materiali i trashëgimisë (ADN dhe ARN)

2

2



P | DT8LY | 1

Rretho pohimin i cili NUK ËSHTË i saktë.

- A. Algat janë të pasura me vitamina dhe minerale.
- B. Algat janë prodhuesi më i madh i ushqimit dhe oksigjenit në Tokë.
- C. Algat janë organizma saprofit.
- D. Janë të rëndësishme si bioindikatore të ndotjes së mjedisit.

2



T | PRV00 | 2

3



P | XWYXF | 2

Gjethet e fieroreve kanë rolet e mëposhtme:

- A. për fotosintezë dhe prodhimin e CO₂
- B. për shumëzim dhe thithjen e materieve minerale
- C. për fotosintezë dhe shumëzim
- D. për frymëmarrje dhe marrjen e ujit

2

4



P | 6PRAW | 2

Rretho pohimin i cili NUK i përshtatet amfibeve.

- A. Marrin frymë përmes lëkurës dhe mushkërive.
- B. Kanë shumëzim të brendshëm.
- C. Kanë kloakën.
- D. Vezët i lëshojnë në ujë.

2

5



P | B562V | 2

Cila nga gjëndrat e mëposhtme NUK KA kanalin e derdhjes?

- A. gjëndrat dhjamore
- B. pankreasit
- C. gjëndrat e djersës
- D. gjëndrat mbi-veshkore

2



T | PRV00 | 3

Në pyetjet nga 6 deri në 10 plotëso me kujdes tabelën.

6



P | 2RDXG | 3

Shëno X para pohimit të duhur (saktë ose pasaktë).

| POHIMI | SAKTË | PASAKTË |
|---|-------|---------|
| Ameba e dizenterisë shkakton diarre gjaku, e cila në trupin e njeriut arrin përmes ujit të infektuar, ushqimit ose duarve. | | |
| Sëmundjen e gjumit e shkakton kamxhiku i rrezikshëm-tripanozoma, ndërsa transmetuesi i sëmundjes është uji i infektuar ose ushqimi. | | |
| Ameba e dizenterisë shkakton sëmundjen e dizenterisë, e cila arrin në trupin e njeriut me pickimin e mushkonjës së infektuar. | | |
| Sëmundjen e malaries e shkakton plazmodiumi malarik, dhe transmetuesi i sëmundjes është femra e mushkonjës. | | |

2



7

Shëno X para pohimit të duhur në tabelë duke lidhur drejtë karakteristikat me llojet e kërpudhave.

| KARAKTERISTIKAT | LLOJET E KËRPUDHAVE | | |
|---|---------------------|------|----------------|
| | Kërpudha | Maja | Myqet (fungus) |
| Kërpudhat janë njëqelizore. Në murin qelizor kanë kitinën, nuk formojnë hife. Janë prodhuesit e fermentimit. | | | |
| Zhvillohen në bukë, fruta, perime, djathë... Mund të prodhojnë antibiotikë. Antibiotiku më i njohur është penicilina. | | | |
| Miceli i këtyre kërpudhave gjendet në tokë. Formojnë trupa frytëdhënës. | | | |

2



T | PRV00 | 5

8



P | 3VQRR | 5

Shëno X para pohimit të duhur (saktë ose e pasaktë).

| POHIMI | SAKTË | PASAKTË |
|------------------------------------|-------|---------|
| Qiparisi është halorë gjetherënës. | | |
| Bredhi është bimë farëzhveshur. | | |
| Cikasin e klasifikojmë tek palmat. | | |
| Pisha krijon boçe. | | |

2

9



P | AYTHV | 5

Duke shënuar shkronjën X në vendin e duhur në tabelë lidh sëmundjet me sistemin përkatës të organeve.

| | |
|--------------|------------------------------|
| 1. Rakiti | A. Sistemi i gjakut |
| 2. Astma | B. Sistemi i frymëmarrjes |
| 3. Hemofilia | C. Sistemi kockor - muskolor |
| 4. Ekzema | D. Lëkura |

| Sëmundjet | Sistemet e organeve | | | |
|-----------|---------------------|----|----|----|
| | A. | B. | C. | D. |
| 1. | | | | |
| 2. | | | | |
| 3. | | | | |
| 4. | | | | |

2



T | PRV00 | 6



P | YXG2H | 6

10

Shëno X para pohimit të duhur (saktë ose e pasaktë).

| POHIMI | SAKTË | PASAKTË |
|---|-------|---------|
| Leucemia është sëmundje e cila kapë qelizat e gjakut. | | |
| Përcjelljen e oksigjenit dhe dyoksidit të karbonit e kryejnë leukocitet. | | |
| Procesi i futjes së gjakut shtesë në sistemin e gjakut quhet transfuzion. | | |
| Trombocitet përmbajnë hemoglobinë. | | |

2

Në pyetjet nga 11 deri në 20 shkruaj përgjigjet në vendin e paraparë.



T | PRVW00 | 7



P | SWN2B | 7

11

Në fotografi është paraqitur një organizëm. Emri shkencor i llojit të cilit i përket është *Trifolium pratense*. Përgjigju në pyetjet.



A. Çfarë në emrin e llojit tregon fjala *Trifolium*?

Përgjigje: _____.

B. Çfarë tregon fjala *pratense*?

Përgjigje: _____.

C. Si quhet familja të cilës i përket ky organizëm?

Përgjigje: _____.

D. Sipas kujt kjo familje e ka marrë emrin?

Përgjigje: _____.

4

12



P | GRCA9 | 7

Bimët janë të rëndësishme për jetën në tokë sepse në procesin e fotosintezës prodhojnë gaz _____.

1



T | PRV00 | 8



P | 7WNFZ | 8

13

Me kujdes vëzhgo figurat dhe përgjigju në pyetjet.



Slika 1.



Slika 2.



Slika 3.



Slika 4.



Slika 5.

A. Cilët organizma kanë aftësinë të nxjerrin stomakun jashtë, dhe kështu fillojnë tretjen e ushqimit jashtë trupit?

Përgjigje: _____.

Në cilën figurë gjinden?

Përgjigje: _____.

B. Rreth vrimës së gojës kanë duar për të kapur ushqimin. Për cilët organizma bëhet fjalë? Përgjigje: _____.

Në cilën figurë janë paraqitur?

Përgjigje: _____.

C. Në anën e stomakut gjendet goja me organin i cili quhet llamba e Aristotelit. Cilët janë këta organizma?

Përgjigje: _____.

Në cilën figurë janë paraqitur?

Përgjigje: _____.

3

14



P | M8JRL | 8

Cilët ruazorë kanë gjëndrat qumështore?

Përgjigje: _____.

1



T | PRVW00 | 9

15



P | DKFFH | 9

Cilat DY grupe ruazorësh janë kafshë gjaknxehtha?

Përgjigje: _____.

2

16



P | MHSCB | 9

Mejoza I quhet gjithashtu ndarja _____, sepse numri i kromozomeve

_____.

2

17



P | C8NTR | 9

A. Indi muskolor është i ndërtuar nga qelizat të cilat quhen _____.

B. Indi muskolor, qelizat e të cilit janë cilindrike dhe me shumë bërthama, quhet

_____.

2



18



P | T5TYK | 10

Qarkullimi i gjakut përmes enëve të gjakut falë punës së zembrës është

_____.

1

19



P | LUMVF | 10

A. Procesi i bashkimit të qelizës vezë dhe spermatozoideve quhet _____.

B. Ky proces kryhet në _____.

2

20



P | CJSYU | 10

Sëmundja shkaktohet nga një virus që sulmon membranat cerebrale dhe indin nervor. Virusi transmetohet me ushqim, ujë, duar të pista. Të sëmurët ndjejnë lodhje të muskujve, nuk mund të lëvizin gjymtyrët, dhe në rastet më të rënda nuk mund të marrin frymë.

A. Cila sëmundje është përshkruar?

Përgjigje: _____

B. Cila është preventiva primare në rastin e kësaj sëmundjeje?

Përgjigje: _____

2



T | PRVW00 | 11

